

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit, Programi Fillor
Titulli i lëndës:	Gjuhë angleze II
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Sc. Agnesa Çanta
Detajet kontaktuese:	Nr. tel. 044 664 301 E-mail add. agnesa.canta@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Gjuhë angleze II është kurs semestral, i cili si vazhdimësi e kursit Gjuhë angleze I do t'i ekspozojë studentët ndaj një sërë situatash komunikative në gjuhën angleze, nëpërmjet të cilave studentët do t'i përmirësojnë aftësitë e tyre komunikuese dhe njëkohësisht t'i avancojnë katër shkathtësitë themelore gjuhësore: të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit, por kësaj rradhe duke përdorur struktura më të ndërlikuara gjuhësore si dhe leksik më të pasur. Kursi konsiston nga një sërë temash duke filluar nga përditshmëria e deri te zhvillimet më të fundit në teknologji, si çështje me shumë interes për të rinjtë, të cilat do t'u ndihmojnë studentëve që shkathtësitë e fituara t'i shfrytëzojnë jo vetëm në situata të ndryshme komunikative, por edhe në funksion të zhvillimit të tyre profesional, nëpërmjet leximit të literaturës profesionale nga fusha e edukimit që përmban fjalor i cili përkon me nivelin e njohurive të fituara gjatë kursit, duke pasur në fokus gërshetimin e kompetencës dhe performansës gjuhësore.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet kryesore të kësaj lënde janë të zhvillojë më tej shkathtësitë komunikuese të studentëve, t'u mundësojë atyre që t'i shprehin pa asnjë vështirësi opinionet e tyre në gjuhën angleze lidhur me temat nga përditshmëria dhe profesioni nëpërmjet bisedave, diskutimeve, eseve, etj., t'u krijojë lehtësi në të kuptuarit e literaturës profesionale në gjuhën

	angleze nëpërmjet zgjerimit dhe pasurimit të fjalorit, duke i angazhuar ata në forma të ndryshme në aktivitetet e organizuara në klasë dhe jashtë saj.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të jenë në gjendje të kuptojnë me lehtësi atë që thuhet dhe të komunikojnë pa vështirësi në gjuhën angleze në kontekste të ndryshme komunikative; 2. Të jenë në gjendje të lexojnë tekste të ndryshme në gjuhën angleze, me përmbajtje më të ndërlikuar; 3. Të jenë në gjendje të shkruajnë ese që përmbajnë deri në 500 fjalë mbi temat të cilat janë diskutuar gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve; 4. Të zbatojnë njohuritë e tyre të gjuhës angleze në funksion të zhvillimit profesional duke përdorur literaturën profesionale në fushën e edukimit që korrespondon me nivelin e shkathhtësive të fituara gjatë kursit; 5. Të krijojnë afinitet të shtuar për lëndën, gjë që pa dyshim do të zgjonte edhe më shumë interesimin për të zgjeruar diapazonin e njohurive të tyre mbi gjuhën angleze. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	15	2	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet,prezentimet , etj.	1	2	2
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Metodologjia e mësimdhënies bazohet kryekëput		

	<p>në Qasjen Komunikative, si ortodoksi dominante në botë në mësimdhënien e gjuhës angleze. Ligjëratat do të zhvillohen në formë interaktive duke i kyçur edhe studentët në diskutime mbi tema të ndryshme të cilat mbulohen në këtë kurs, duke u dhënë udhëzime për përdorim të drejtë të gjuhës, si dhe duke organizuar një sërë aktivitete të cilat imitojnë përdorimin e gjuhës angleze jashtë klasës, siç janë: puna në cifte, puna në grupe, etj., në mënyrë që studentët të përgatiten që ta përdorin gjuhën, jo vetëm në klasë, por edhe jashtë saj. Diskutimet në kuadër të ushtrimeve do të zhvillohen në grupe të vogla në mënyrë që të nxitet karakteri garues i studentëve. Poashtu, edhe prezantimet e projekteve dhe detyrave të tjera në kuadër të kursit do të jenë pjesë integrale e të mësuarit që do të ndikojnë në përmirësimin e shkathësive gjuhësore të studentëve.</p>
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i studentëve do të bëhet konform disa kriterëve të cilat do ta përcaktojnë notën përfundimtare. Këtu përfshihen:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Performansa e studentëve në detyrat, projektet që i punojnë gjatë semestrit 10% 2. Performansa e tyre në kollokvium 20% 3. Angazhimi i tyre gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve 10% 4. Provimi përfundimtar 60%
Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Richards, Jack, C., with Hull, Jonathan & Proctor, Susan (2012). <i>Interchange 2</i>, Fourth Edition. New York, NY: Cambridge University Press.
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 2. Altenberg, Evelyn, P. & Vago, Robert, M. (2010). <i>English Grammar, Understanding the Basics</i>. New York, NY: Cambridge University Press. 3. Cotton, David & Falvey, David & Kent, Simon. (2010). <i>Market Leader, Intermediate</i>, 3rd Edition, London: Pearson Longman, ELT. 4. Vince, Michael (2008). <i>Macmillan English Grammar in Context</i>, Intermediate with key. Oxford: Macmillan Education. 5. Materiale të ndryshme nga Interneti
Plani i dizajnuar i mësimi:	

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Introduction
Java e dytë:	Unit 1 A time to remember. Getting to know you. Past Simple Tense. Used to. Memories.
Java e tretë:	Unit 2 Caught in the rush. Compound nouns. Adverbs of Quantity. Indirect questions from Wh-questions. New Ways of Getting Around.
Java e katërt:	Unit 3 Time for a change! Houses and apartments. Evaluations and comparisons. Grammar focus: <i>wish</i> . Break those bad habits.
Java e pestë:	Unit 4 I've never heard that! Favourite Ethnic Dishes. Simple past vs. present perfect. Sequence adverbs. Food & Mood.
Java e gjashtë:	Unit 5 Going places. Vacations. Future with <i>be going to</i> and <i>will</i> . Modals for necessity and suggestion. Volunteer Travel - A vacation with a difference.
Java e shtatë:	Unit 6 OK. No problem! Common Complaints of Families with Teenagers. Two-part verbs. Requests with modals and Would you mind...? How to Ask for a Favour?
Java e tetë:	Unit 7 What's this for? The Invention of Everyday Objects. Infinitives and gerunds for uses and purposes. Imperatives and infinitives for giving suggestions. Modern-Day Treasure Hunters.
Java e nëntë:	Pre-test
Java e dhjetë:	Unit 8 Let's celebrate! Holidays and Festivals. Collocations. Relative & adverbial clauses of time. Customs Around the World.
Java e njëmbëdhjetë:	Unit 9 Times have changed ! Time contrasts. Conditional sentences with <i>if</i> clauses. Consequences. Are you in LOVE?
Java e dymbëdhjetë:	Unit 10 I hate working on weekends! Eight important job skills. Gerunds; short responses. Clauses with <i>because</i> . Find the Job That's Right For You!
Java e trembëdhjetë:	Unit 11 It's really worth seeing! Modern Wonders. Passive with and without <i>by</i> . A Guide to Unusual Museums.
Java e katërmbëdhjetë:	Unit 12 What happened? Accidental inventions. Storytelling. Past continuous vs. simple past. Present perfect continuous. From the Streets to the Screen.
Java e pesëmbëdhjetë:	Review of Units 1-12

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p>Studentët duhet të jenë të përgjegjshëm dhe të respektojnë institucionin dhe rregullat akademike. Ata duhet t'i vijnë ligjëratat dhe ushtrimet me rregull dhe të tregojnë interesim dhe angazhim të vazhdueshëm për lëndën, vullnet për të bashkëpunuar me njeri-tjetrin dhe respekt për të gjithë personat që i rrethojnë. Ata duhet t'i ndjekin me përpikmëri udhëzimet e mësimit të tyre gjatë punëve seminarike dhe detyrave të tjera në kuadër të studimeve. Provimet vlerësohen individualisht për secilin student,</p>

prandaj ata duhet të përqëndrohen në njohuritë e tyre personale. Kopjimi është i ndaluar. Poashtu, studentët janë të obliguar ta kenë me vete në provim indeksin ose ID-në e studentit, përndryshe nuk mund t'i nënshtrohen provimit. Shkelja eventuale e këtyre rregullave dhe në përgjithësi të gjitha rregullave të parapara sipas Statutit të Universitetit të Prishtinës ndëshkohet konform normave ligjore.